



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 198, Datë 03.08.2022**

**MBI**

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 181, DATË  
13.07.2022 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “NRG POWER” SH.P.K. NË  
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 03.08.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1379/6 prot., datë 27.07.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 181, datë 13.07.2022 “Mbi licencimin e shoqërisë “NRG POWER” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 181, datë 13.07.2022, vendosi të licencojë shoqërinë “NRG Power” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
- Shoqëria kishte detyrimin që brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja dijani e këtij vendimi, të depozitonte në ERE vërtetimin e gjykatës për administratorin e saj.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 674/4 prot., datë 18.07.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e kërkuar, brenda afatit të përcaktuar.
- Me depozitimin e dokumentacionit të kërkuar, duhet shfuqizuar pika 2 dhe pika 3 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 181/2022.
- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të shfuqizojë pikën 2 dhe pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 181, datë 13.07.2022 “Mbi licencimin e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**